



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1171 Prot.

Tiranë, më 25.10.2023

### V E N D I M

**Nr. 217, datë 25.10. 2023**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>2</sup>, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 139 Regj, datë 07.07.2023, paraqitur nga z.Dh.Z, kundër Bashkisë Korçë dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a Korçë (OSHEE sh.a Korçë), në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes familjare” dhe “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, ankuesi Dh.Z shpjegon se, prej periudhës 01.03.2023 deri më 01.03.2024, në bazë të vendimit të KMCAE Epror, gëzon statusin e verbërisë, grupi i parë. Duke gëzuar këtë status, ai pretendon se, si gjithë të tjerët ka të drejtën të jetë përfitues i politikave që shteti ka për këtë kategori, në bazë të VKM nr.404, datë 20.06.2012, i ndryshuar, ku një prej përfitimeve është bonusi/kompesimi prej 3 000 lekë për energjinë elektrike.

Ankuesi informon se, ka hasur në vështirësi nga OSHE Korçë për të marrë këtë kompesim. Sipas ankuesit, në çertifikatën familjare ai është bashkë me djalin e tij, ndërsa çertifikata e pronësisë së shtëpisë ku jeton, është në emër të djalit të tij. Sipas ankuesit, ky kompesim nuk i është ofruar

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

pasi shtëpia ku ai jeton është në emër të djalit të tij. Ankuesi pretendon se, punonjësit e këtij institucioni i kanë thënë se ai duhet të jetë patjetër pjesë e çertifikatës së pronësisë për ta përfituar kompesimin e energjisë elektrike, ndërkohë që sipas ankuesit, persona të tjerë të cilët gëzojnë të njëjtin status si ai, e marrin 3 000 lekëshin edhe pse nuk janë pjesë e çertifikatës së pronësisë, por janë vetëm në çertifikatën familjare.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri zgjidhjen e problemit dhe përfitimin e bonusit/kompesimit të energjisë elektrike si person që gëzon statusin e verbërisë, grupi i parë.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohej *ndaj çdo veprimi ose mosveprimi* të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët *publikë ose privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, rezultoi se, ankesa nuk plotësonte të gjitha kriteret formale për pranimin e saj. Ankesa u plotësua me dokumentacionin e nevojshëm për të vijuar më tej procedurat e shqyrtimit në datën 19.07.2023, nëpërmjet Zyrës Rajonale Korçë, të Komisionerit.

Pas plotësimit të ankesës, në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.844/1 prot., datë 07.08.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion në lidhje me pretendimet e parashtruara nga pala ankuese, nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Korçë sh.a (OSHEE sh.a Korçë) dhe Bashkia Korçë, në cilësinë e subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa.

1.1 Me shkresën nr.6083/1 prot., datë 11.08.2023, Bashkia Korçë ktheu përgjigje, duke informuar, ndër të tjera se:

z. Dh.Z është përfitues i pagesës së paaftësisë me Status Verbërie, nga Drejtoria e Kujdesit Social, që prej datës 01.03.2023. Krahas pagesës së paaftësisë, personat që trajtohen me Statusin e të Verbërit, janë njëkohësisht edhe përfitues të kompesimit të energjisë elektrike dhe faturës së telefonisë fikse. Ankuesi është paraqitur dhe është sqaruar në lidhje me procedurën dhe dokumentacionin që duhet të paraqesë për të përfituar nga kompesimi financiar për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse.

Kjo procedurë është parashikuar në Vendimin nr.404, datë 20.06.2012 *“Për përcaktimin e masës së kriterëve e të procedurave të përfitimit të kompesimit financiar, nga personat me statusin e të verbërit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”*. Sipas nenit 8, gërma “c”, për dokumentacionin që duhet të paraqesë pranë administratorit shoqëror në njësitë e qeverisjes vendore, ankuesi duhet të dorëzojë një kopje të kontratës me entin shpërndarës të energjisë elektrike. z. Dh.Z, nuk e disponon dhe nuk e ka paraqitur këtë dokument.

Referuar pretendimeve të z.Dh.Z, në kontaktet e vazhdueshme që kemi patur me Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi Korçë, janë diskutuar edhe kompetencat e bashkisë dhe institucioneve të tjera përfshirëse, për t’i dhënë zgjidhje sa më shpejt rastit konkret.

2. Me shkresën nr.844/3 prot, datë 14.09.2023, Komisioneri i komunikoi palës ankuese përgjigjen e depozituar nga Bashkia Korçë nëpërmjet shkresës nr.6083/1 prot., datë 11.08.2023. Pala ankuese nuk depozitoi parashtrime apo kundërshtime në lidhje me përgjigjen e Bashkisë Korçë.

3. Zyra Rajonale e Komisionerit në Korçë, informoi se, nga informacioni që kishte marrë në lidhje me rastin pritej të depozitohet vetëm kontrata e energjisë në mënyrë që çështja të merrte zgjidhje dhe z. Z. të ishte përfitues i rimbursimit të energjisë elektrike, por nga ana e ankuesit nuk ishte depozituar dokumentacioni i kërkuar.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

## A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesi Dh.Z, është i datëlindjes 18.08.1936, lindur dhe banues në Korçë. Referuar vërtetimit të datës 25.04.2023, lëshuar nga KMCAP-i Epror i Verbërisë, rezulton se, me Vendimin nr.426 datë 25.04.2023, të Komisionit Epror të Verbërisë, z. Dh.Z është caktuar se plotëson kushtet e përfitimit nga “Statusi i të Verbërit”, grupi I (Parë), nga data 01.03.2023 deri më datë 01.03.2024, dhe se ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër. Rezulton se në cilësinë e ndihmësit personal (kujdestarit) për z. Z. është caktuar vajza e tij A. Z. Si përfitues nga “Statusi i të Verbërit”, ankuesi është pajisur nga Shërbimi Social Shtetëror me librezën “Për Përfituesit e Statusit të të Verbërit”. Referuar çertifikatës familjare të datës 22.06.2023, të Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative Korçë, Bashkia Korçë, ankuesi figuron kryefamiljar. Në përbërjen familjare ankuesi është së bashku me djalin dhe familjen e këtij të fundit, të përbërë nga bashkëshortja dhe dy vajza.

Ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të gjendjes familjare dhe aftësisë së kufizuar, pasi i është mohuar e drejta për të përfituar kompesimin e energjisë elektrike që përfitohet nga personat me aftësi të kufizuar në shikim që përfitojnë nga “Statusi i të Verbërit”.

Në bazë të nenit 3, pika 1 të LMD, diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Në Kreun IV, të LMD, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD, në nenin 20, pika 1, përcakton se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”. Më specifikisht në pikën 2, germa “c”, të nenit 20, të LMD, parashikohet se : “2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;”

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një ose më shumë nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga LMD.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm në lidhje me të drejtën për të përfituar kompesimin e energjisë elektrike si person me aftësi të kufizuar.

Pretendimi i ankuesit për të përfituar kompesimin e energjisë elektrike për personat me aftësi të kufizuar në shikim (personat që përfitojnë nga “Statusi i të verbërit”) rregullohet bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.404, datë 20.6.2012 “Për përcaktimin e masës së kriterëve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”, i ndryshuar me Vendimin Nr.616, datë 22.9.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 404, datë 20.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së kriterëve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”” (në vijim VKM Nr.404, datë 20.06.2012, i ndryshuar). Kjo VKM parashikon si më poshtë vijon:

“2. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 3 000 (tre mijë) lekë në muaj.

3. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar dhe individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të cilët nuk kanë nevojë për kujdestarë, u jepet një kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 2 400 (dy mijë e katërqind) lekë në muaj.

.....

5. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të cilët kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e telefonisë fikse, në masën 1 000 (një mijë) lekë në muaj.

6. Masa e kompensimit llogaritet dhe përfitohet pranë njësisë së qeverisjes vendore ku individi i verbër, paraplegjik dhe tetraplegjik, ka vendbanimin.

.....  
8. Për përfitimin e kompensimit të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse, të përcaktuara sipas pikave 1, 2, 3, 4 e 5 të këtij vendimi, individët duhet të paraqesin pranë administratorëve shoqërorë në njësitë e qeverisjes vendore dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesë për të përfituar kompensim dhe deklaratën sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi;  
b) certifikatë familjare, që vërteton se individi është anëtar i familjes, e cila rinovohet çdo fillim viti;

c) kopjen e kontratës me entin shpërndarës të energjisë elektrike;

ç) kopjen e librezës së energjisë elektrike, e cila dorëzohet çdo fillim viti;

d) kopjen e kontratës me entin e shërbimit të telefonisë fikse; dh) kopjen e librezës së telefonisë fikse, e cila dorëzohet çdo fillim viti.

e) kopje të librezave të paraplegjikut dhe tetraplegjikut apo të verbërisë, të lëshuara nga Shërbimi Social Shtetëror.

9. Njësitë e qeverisjes vendore i shpërndajnë pagesat për kompensimin e faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse nga shërbimet bankare ose “Posta Shqiptare” sh.a.”

Sa më sipër rezulton se, bazuar në VKM Nr.404, datë 20.06.2012, të ndryshuar, ankuesit Dh. Z., i cili është person me aftësi të kufizuara në shikim dhe është vlerësuar si përfitues i “Statusit të të Verbërit” dhe që ka nevojë për përkujdesjen e vazhdueshme të një personi, pra për një ndihmës personal (kujdestar), i lind e drejta për të përfituar kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 3 000 (tre mijë) lekë në muaj dhe kompensim për faturën e telefonisë fikse, në masën 1 000 (një mijë) lekë në muaj. Në ankesën objekt shqyrtimi, pretendimi i ankuesit konsiston vetëm në përfitimin e kompensimit të faturës së energjisë elektrike dhe jo kompensimin për faturën e telefonisë fikse.

Për përfitimin e kompensimit të faturës së energjisë elektrike, individët duhet të paraqesin pranë administratorëve shoqërorë në njësitë e qeverisjes vendore dokumentacionin, e përcaktuar në pikën 8, të VKM Nr.404, datë 20.06.2012, të ndryshuar. Referuar procedurave të përcaktuara në VKM Nr.404, datë 20.06.2012, të ndryshuar, rezulton se, masa e kompensimit llogaritet dhe përfitohet pranë njësisë së qeverisjes vendore ku individi i verbër, paraplegjik dhe tetraplegjik, ka vendbanimin, që në rastin konkret është Bashkia Korçë, meqënëse ankuesi e ka vendbanimin në këtë bashki.

Ankuesi pretendon se, i është refuzuar kompensimi i energjisë elektrike në masën 3 000 (tre mijë) lekë sipas VKM Nr.404, datë 20.06.2012, të ndryshuar, me arsyetimin se, shtëpia ku jeton është

në emër të djalit të tij, pavarësisht se ata janë në të njëjtën certifikatë familjare. Bashkia Korçë nëpërmjet shkresës nr.6083/1 prot, datë 11.08.2023, parashtroi se, ankuesi Dh Z. është paraqitur në zyrat e Bashkisë Korçë dhe është sqaruar në lidhje me procedurën dhe dokumentacionin që duhet të depozitohet për të përfituar kompesimin financiar për faturën e energjisë elektrike. Nëpërmjet kësaj shkrese, Bashkia Korçë, informon se, z. Z. nuk ka depozituar kopjen e kontratës me entin shpërndarës të energjisë elektrike, një dokument ky që kërkohet sipas pikës 8, gërma “c”, të VKM Nr.404, datë 20.06.2012, të ndryshuar.

Referuar VKM Nr.404, datë 20.06.2012, të ndryshuar, nuk parashikohet si kusht që personi me aftësi të kufizuar në shikim i cili kërkon të përfitojë kompesimin e faturës së energjisë elektrike të jetë pronar apo bashkëpronar i banesës. Referuar gërmës “c” të pikës 8, të VKM Nr.404, datë 20.06.2012, të ndryshuar, dokumentacioni që kërkohet është, kopja e kontratës me entin shpërndarës të energjisë elektrike. Kopja e kontratës me entin shpërndarës të energjisë elektrike, është një dokument i cili duhet të depozitohet nga ana e personit që kërkon të përfitojë kompesimin e energjisë elektrike sipas kësaj VKM-je.

Pavarësisht se ankuesit iu komunikua shkresa nr. 6083/1 prot, datë 11.08.2023, e Bashkisë Korçë, ai nuk paraqiti asnjë prapësim në lidhje me pretendime e Bashkisë Korçë dhe faktin se ai nuk kishte depozituar dokumentacionin e nevojshëm për të përfituar kompesimin e kërkuar të faturës së energjisë elektrike. Gjatë shqyrtimit të ankesës, ankuesi nuk depozitoi pranë Komisionerit kopje të kontratës me entin shpërndarës të energjisë elektrike, si dhe nuk provoi që t'a ketë depozituar këtë dokument pranë Bashkisë Korçë.

Komisioneri konstaton se, ankuesi nuk rezulton që të ketë depozituar të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas VKM-së nr.404, datë 20.06.2012, i ndryshuar. Në kushtet kur, ankuesi nuk ka depozituar të gjithë dokumentacionin e kërkuar për të përfituar kompesimin e energjisë elektrike sipas VKM-së, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm nga ana e Bashkisë Korçë në lidhje me përfitimin e kompesimit të energjisë elektrike.

Ankuesi e ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi kundër dy subjekteve, Bashkisë Korçë dhe OSHEE sh.a Korçë. Bazuar në VKM Nr.404, datë 20.06.2012, i ndryshuar, Komisioneri konstaton se, OSHEE sh.a Korçë nuk ka legjitimitet pasiv, pasi nuk është mbajtes i detyrimit të pretenduar nga ankuesi. Referuar procedurave të përcaktuara nga VKM Nr.404, datë 20.06.2012, të ndryshuar, OSHEE sh.a Korçë nuk ka asnjë detyrim, por e gjithë procedura për përfitimin e kompensimit të faturës së energjisë elektrike kryhet nga ana e Bashkisë Korçë. Në këtë kuptim, pretendimi i ankuesit nuk mund t'i kundërdrejtohet OSHEE sh.a Korçë, pasi detyrimi juridik i pretenduar nga ankuesi nuk rëndon mbi këtë subjekt.

Sa më sipër dhe bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se, ankuesi Dh.Z, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Bashkisë Korçë dhe OSHEE sh.a Korçë. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit Dh.Z, për shkak të “*gjendjes familjare*” dhe “*aftësisë së kufizuar*”, nga ana e Bashkisë Korçë dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, Korçë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Aftësia e kufizuar, gjendja familjare  
Fusha: Të mira dhe shërbime  
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim